



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

Rruga Ukshin Kovaqica, Mitrovicë, Republika e Kosovës
<http://www.umib.net>; Tel: +381-28535725/535727

Kryesues i Këshillit Drejtues
Dr. sc. Ali Topalli

Nr. Prot. 299/005
Dt 01.03.2019

Këshilli Drejtues i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 21.2.2019, mori:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e dekanit të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike, prof. dr. Hakif Zeqiri, ndaj vendimit të rektorit nr. prot. 1875, dt. 05.12.2018, për shqiptimin e masës disiplinore "Vërejtje me Shkrim".

Arsyetim

Dekani i Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike, prof. dr. Hakif Zeqiri, ka parashtruar ankesën nr. prot. 2017, të datës 19.12.2018, ndaj vendimit të rektorit nr. prot. 1875, dt. 05.12.2018, për shqiptimin e masës disiplinore "Vërejtje me Shkrim". Ankesën e tij, ankimesi e bazon në mosrespektimin e procedurave të përcaktuara me Kodin e Etikës, përkatësisht nenin 31, pika 1, dhe nenin 34 dhe 35 të këtij Kodi.

Këshilli Drejtues, pasi shqyrtoi ankesën e dekanit të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike, prof. dr. Hakif Zeqiri, ndaj vendimit të rektorit nr. prot. 1875, dt. 05.12.2018, për shqiptimin e masës disiplinore "Vërejtje me Shkrim", si dhe vendimin e rektorit nr. prot. 1875, dt. 05.12.2018, për shqiptimin e masës disiplinore "Vërejtje me Shkrim", konstatoi se ankesa është e pabazuar, për arsye se shqiptimi i masës disiplinore është marrë për shkak se gjatë ushtrimit të detyrës dekanit nuk ka reaguar dhe nuk ka vepruar për marrjen e masave adekuate sipas përgjegjësive të përcaktuara me Statut për pozitën e dekanit (neni 73 i Statutit të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini"). Konkretisht, Rektori i Universitetit të Mitrovicës pas incidentit të ndodhur më datë 27.11.2018 në sallën e mësimi AM/3 në objektin e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike dhe të Fakultetit të Edukimit të paraqitur në ankesën nr. prot. 1792, të datës 27.11.2018 të parashtruar nga një grup i studentëve të Fakultetit të Edukimit ndaj të punësuarit të Universitetit të Mitrovicës, Fitim Zeqirit, asistent në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike, si dhe kërkesën nr. prot. 1871 të datës 05.12.2018 të paraqitur nga ass. Fatbardha Hoxha, asistente në Fakultetin e Edukimit, në takim zyrtar ka kërkuar nga dekan i Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike, prof. dr. Hakif Zeqiri, që në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësive të përcaktuara me Statut për pozitën e dekanit, të marrë masat adekuate konform rregullativës ligjore ndaj ass. Fitim Zeqiri, asistent në Fakultetin e Inxhinierisë mekanike dhe Kompjuterike. Z. Hakif Zeqiri, dekan i Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike, si udhëheqës i njësisë akademike dhe menaxher i drejtpërdrejtë i ass. Fitim Zeqirit, gjatë kësaj periudhe nuk ka ndërmarrë e as nuk ka propozuar ndërmarrjen e ndonjë mase për menaxhimin e situatës së krijuar, me qëllim që studentëve dhe stafit t'u sigurohet ambient i sigurt mësimi dhe pune. Kjo do të thotë se masa disiplinore Vërejtje me Shkrim, të përmendurit nuk i është shqiptuar për shkak të shkeljeve të detyrave të punës në cilësinë e mësimdhënësit, (ku vjen në shprehje zbatimi i procedurave të Kodit të Etikës), por për shkak të mosmenaxhimit të situatës së krijuar në cilësinë e **dekanit të njësisë akademike**, pozitë kjo mandatore, që nuk ka të bëjë me marrëdhënien e rregullt të punës. Bazuar në këto që u cek si më lartë, Këshilli Drejtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Inspektoratin e Arsimit brenda afatit prej 15 ditësh (neni 170, paragrafi 3.6.).

Ky vendim i dorëzohet:

1. Arkivit të UMIB-it,
2. Të përmendurit.



Kryesuesi Këshillit Drejtues

Dr. sc. Ali Topalli